Nr. i prot. 2025/ZDP/92
Faqe: 1 Kopja: / Data: 10/03/2025
Dalës/izlazno/out: X
Prishtinë/Priština/Pristina

10/ZDP/VE/2025
Datë: 10 mars 2025

Në mbështetje të nenit 15.1 (j), nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-05 1 për Aviacionin Civil, të ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të Agjencive të Pavarura; neneve 76.3 dhe 115 të Rregullores (AAC) Nr. 05/2020 për Rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 10/2015 dhe shfuqizimin e Rregullores (AAC) Nr. 11/2009, Rregullores (AAC) Nr. 03/2009 dhe Rregullores (AAC) Nr. 6/2009; Rregulloren (AAC) Nr. 08/2020 që përcakton rregullat e hollësishme për operimin e veloreve në përputhje me Rregulloren (AAC) Nr. 05/2020; dhe Udhëzimit Administrativ (AAC) Nr. 02/2021 për zbatimin e specifikimeve të certifikimit, mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë dhe materialeve udhëzuese të EASA;
Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr:

**VENDIM**

1. Për zbatim në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës të mjeteve të pranueshme të pajtueshmërisë (AMC) materialeve udhëzuese (GM) dhe të specifikimeve të certifikimit (CS), bazuar në vendimet e lëshuara nga EASA deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, në fushën e operimeve me velore, në vijim:
   a) Mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë/materialet udhëzuese (AMC/GM) për Rregulloren (AAC) Nr. 08/2020, janë:

      **AMC & GM të Rregullores**

      2019/001/R Botimi fillestar
      2020/004/R Botimi 1

   b) Specifikimet e certifikimit/ mjetet e pranueshme të pajtueshmërisë (CS/AMC) për Rregulloren (AAC) Nr. 08/2020, janë:

      **CS & AMC të Part-SAO**

      2003/13/RM CS-22/ Botimi fillestar
      2008/008/R CS-22/ Amandamenti 1
      2009/009/R CS-22/ Amandamenti 2

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Burim Dinarama**
U.D. Drejtor i Përgjithshëm

Iu dërgohet:
- Njësisë përgjegjëse të Sigurisë së Fluturimeve në AAC;
- Arkivi të AAC-së.